



KONTRATE
DHURIMI KUOTASH

Sot, me datën 03/03/2015 (Tre Mars dymijë e pesëmbëdhjetë), dite e Marte, para meje notere Teuta Rr. HOXHA, anetare e Dhomes së Notereve Durrës, me seli në Lagjen "Aqif Pasha" Rr. "28 Nëntori", Elbasan, u paraqiten personalisht palet nën cilesinë e:

Pala Dhuruese : Shpresa Banja, e bija e Hamit-it, lindur me dt. 14-10-1954 në Durrës dhe banuese në Elbasan në Lagjen "Aqif Pasha", madhore me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, mbajtese e kartës së identitetit Nr. 02470052 dhe nr. Personal F46014004I leshuar me dt. 27-03-2009, e perfaqësuar në këtë akt nga Znj. Nertila Toli e bija e Rustem-it e dtl 28-01-1985, i lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan e identifikuar nga karta e saj e identitetit Nr. 027688771 dhe nr. Personal I55128065S nepermjet prokures së posacme Nr. 3951 Rep dhe Nr. 885 Kol date 26-08-2014 e redaktuar nga noteria Ornela H. Guranjaku me qender në Lagjen "Aqif pasha", Elbasan.

Pala Pranuese e Dhurimit: Ermal Banja, i biri i Fuat-it, lindur me dt. 10-09-1985 në Elbasan dhe banues në Elbasan në lagjen;" Aqif Pasha", madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me anë të kartës së identitetit, nr. 024632724 dhe Nr. I50910076D Personal leshuar me dt. 19-03-2009

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash si me poshte:

Pala Dhuruese: Shpresa Banja është ortakia e vetme të shoqërisë "LOERMA" shpk, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik, me NIPT L02928204T me seli në Elbasan lagja "Aqif Pasha", Rr. 28 Nentori, pallati 77/5

Ortaku i vetëm i shoqërisë "LOERMA" shpk, znj. Shpresa Banja zoteruesi i 100% të kuotave, sipas regjistrimit në QKR me dt 28/05/2010 e cila ka vendosur transferimin nepermjet dhurimit të 100 kuotave, me vlerë të përgjithshme 100.000,00 Leke, që përbejnë 100% të kapitalit të shoqërisë, në favor të Z. Ermal Banja, administratori i shoqërisë "LOERMA" shpk

Pas këtij transferimi ortak i vetëm Shpresa Banja, pala dhuruese heq dorë nga shoqëria "LOERMA" shpk, duke dhe pala pranuese e dhurimit behet ortak i ri i vetëm me 100 kuota me vlerë të përgjithshme 100.000,00 Leke, që perfaqesojne 100% të kapitalit të shoqërisë "LOERMA" shpk.

Objekti i kontrates

Pala Dhuruese, Shpresa Banja transferon me anë të kesaj kontrate me vullnet të lire e të plote në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, 100 kuota, me vlerë të përgjithshme 100.000,00 Leke, që përbejnë 100% të kapitalit të shoqërisë të zotëruar prej saj në shoqërinë "LOERMA" shpk, në favor të pales pranuese të dhurimit Ermal Banja

Vlera monetare e dhurimit

Vlera monetare e dhurimit të 100 kuotave, që perfaqesojne 100 % të kapitalit të zotëruar nga Shpresa Banja në shoqërinë "LOERMA" shpk, dhe që transferohet nepermjet kesaj kontrate në favor të administratorit të shoqërisë z. Ermal Banja është 100.000,00 Leke (njëqind mijë lek).

Handwritten signature in blue ink.

Handwritten signature in blue ink.



Pala Pranuese e Dhurimit deklararon se pranon dhurimin sipas paragrafit te mesiperm dhe eshte plotesisht dakort te jete ortakut i ri i vetem i shoqerise "LOERMA" shpk dhe nuk ka asnje pretendim.

Garancite

Dhuruesi deklararon dhe garanton ne daten e nenshkrimimit te kesaj kontrate se eshte pronar i kuotave te cituara ne kushtet paraprake. Kuotat jane te lira nga cdo barre apo detyrim ligjor dhe Dhuruesi ka te drejta te plota per ti dhuruar dhe transferuar ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate apo pretendim tjetet ligjor.

Heqje dore nga te drejtat

Dhuruesi deklararon nen pergjegjesine e tij personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne ne cilesine e ortakut te shoqerise pas nenshkrimimit te kesaj kontrate.

Te ndryshme

Kjo kontrate e shkruar perben te gjithe marreveshjen ndermjet paleve dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme te kryera verbalisht apo me shkrim dhe cdo komunikim te meparshem ndermjet paleve qe lidhet mew objektin e kesaj Kontrate

Pas realizimit te ketij transferimi kuotash me nenshkrimin e kesaj kontrate Pala pranuese e Dhurimit z. Ermal Banja, behet pronar i ligjshem i vetem i 100 kuotave me vlere te pergjithshme 100.000,00 Leke (njeqind mije lek), qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise "LOERMA" shpk,

Anekset e kontrates

- Mjetet identifikuese te paleve
- Prokura e posacme
- Çertifikata e regjistrimit te shoqerise tregtare "LOERMA" SHPK

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe.

Palet deklaruan se jane dakord me sa me siper, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan rregullisht perpara meje dhe une noterja, e vertetoj ate sipas ligjit.

Pala dhuruese

Shpresa Banja e perfaqesuar nga

Mertila Kadi utoloff

Pala Pranuese e dhurimit

Ermal Banja

[Signature]

Teuta Rr, Hoxha



[Signature]

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

LOERMA – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Elbasan, Elbasan, Lagjja Aqif Pasha, rruga 28 Nentori, pallati 77/5

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

L02928204T

Afati i veprimtarisë:

Nga: 28/05/2010 deri 28/05/2030

DATA E REGJISTRIMIT

28/05/2010

DATA E LËSHIMIT

31-05-2010

SPORTELI I SHËRBIMIT:

ELBASAN



QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

Elis Bebell



REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERISË DURRËS
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
Nr Rep. 3951 Nr Kol. 885

TAKSA E PËRVEÇTIMIT
U LIKUIDIT



NOTERE
Ornela H. Guranjaku
L. "Aqif Pasha", ELBASAN,
Albania
Nr. Tel 0697511079

PROKURË E POSAÇME

Sot me datë 26.08.2014 (Njëzet e Gjashte Gusht Dymijë e Katërmbëdhjetë) para meje Notere Ornela H. Guranjaku, anëtare e Dhomës së Noterëve Durrës, me seli pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan u paraqit personalisht shtetësja :

Znj. SHPRESA HAMIT BANJA e datëlindjes 14.10.1954, lindur në Durrës dhe banuese në Lagjen "Aqif Pasha" Elbasan, identifikuar nga Unë Noterja nëpërmjet kartës së identitetit me nr. Personal F46014004I lëshuar me datë 04.09.2009 dhe e vlefshme deri me datë 03.09.2019.

Madhore me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, e cila me vullnetin e saj të lirë më kërkoi Mua Noteres hartimin e kësaj Prokure të Posaçme.

Unë e përfaqsuara znj. SHPRESA BANJA me vullnetin tim të lirë dhe të plotë deklaroj se emëroj si përfaqsesen time të posaçme: **NERTILA RUSTEM TOLI** e datëlindjes 28.01.1985 lindur në Elbasan dhe banuese në lagjen "Kongresi Elbasanit" Elbasan, e pajisur me kartë identiteti me nr. Personal I55128065S lëshuar me datë 02.10.2009 dhe e vlefshme deri me datë 01.10.2019 e cila, në emër dhe për llogarinë time, autorizohet të më përfaqësojë në mungesën time në rrugë ligjore, administrative dhe financiare që kanë të bëjnë me :

- Paraqitjen pranë çdo zyre të administratës të pushtetit qendror dhe atij lokal si dhe në çdo subjekt privat, për të kërkuar informacion, për të dorëzuar dhe tërhequr dokumenta që janë të domosdoshme për funksionimin ligjor dhe administrativ të Forumit të Gruas Elbasan dhe LOERMA sh.p.k.
- Të paraqitet pranë Q.K.R. dhe Q.K.L. në emër dhe për llogarinë time, për të kryer çdo veprim ligjor, administrativ dhe financiar për Forumin e Gruas Elbasan dhe LOERMA sh.p.k.
- Të paraqitet në organin e Tatim Taksave, për të bërë veprime të ndryshme të dorëzimit dhe të tërheqjes së dokumentave të domosdoshme si dhe çdo veprim tjetër të domosdoshëm me qëllimin përfundimtar, funksionimin ligjor dhe administrativ të Forimit të Gruas Elbasan dhe LOERMA sh.p.k.
- Të ketë të drejtën e paraqitjes pranë Bankës Kombëtare Tregëtare, dhe Intesa San Paolo si dhe të çdo banke tjetër, për të kryer çdo lloj veprimi bankar.
- Të ketë të drejtën të lidhë dhe të nënshkruajë kontrata të ndryshme me persona të tretë fizike ose juridikë, si dhe me donatorë shqipëtarë ose të huaj, me të drejtën e përcaktimit vetë, të të gjitha kushteve të kontratës apo çdo akt noterial dhe deklarim që lidhen me zbatimin e projekteve të Forumit të Gruas Elbasan dhe LOERMA sh.p.k.

Për të gjitha tagrat e dhëna më sipër, përfaqseses i kaloj të gjitha të drejtat që më njeh ligji material e procedurial në mbrojtje të interesave të Forumit të Gruas Elbasan dhe LOERMA sh.p.k.

[Handwritten signature]

